

MNN Qendrore

MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

10 Shtator 2025

Rajoni SHBA/Kanada



Shtetet e Bashkuara

Puna e Kishës së Nazaretasit filloi zyrtarisht në Shtetet e Bashkuara në vitin 1887, megjithëse organizimi formal i denominacionit ndodhi në vitin 1908 me bashkimin e disa grupeve të shenjtërisë me mendime të ngjajshme. Sot, Nazaretasit mblidhen në kisha lokale në çdo shtet të SHBA-së. Ka një theks të ri në ungjillizim, dishepullizim dhe mbjellje kishash, duke angazhuar të gjitha moshat në misionin e Perëndisë. Të rinjtë po zënë vendin e tyre si udhëheqës dhe punonjës misionarë, duke kaluar kufijtë përtej zonave të tyre të rehatisë, për të ndarë Lajmin e Mirë të Jezusit. Mesazhi i Shenjtërisë Biblike është më i rëndësishëm se kurrë dhe përfaqon dhe sfidon të gjitha moshat.



558,147 Anëtarë



4,216 Kisha të
Organizuara; 685 Kisha
të paorganizuara ende



2,129 Shërbëtorë të
Liçensuar dhe 11,223
Shërbëtorë të Shuguruar
në 73 Distrikte

LUTJE



- Lutuni që Zoti të vazhdojë t'i thërrasë të rinjtë në shërbesë për hir të të tjerëve.
- Lutuni që mundësitë e shërbimit të transformojnë jetën e të rinjve dhe t'i zgjojë ata ndaj një bote më të madhe që ka nevojë të dëgjojë për Jezusin.

LAVDËRIM



- Lavdëroni Perëndinë për shumë jetë të reja që janë ndryshuar nga pjesëmarrja në C.A.R.E. (Kujdesi për të Arritur të Gjithë).
- Falenderoni Zotin për interesin në rritje midis nxënësve të shkollave të mesme dhe të shkollave të mesme të ulëta për të shkuar dhe për të shërbyer, duke ndarë Lajmin e Mirë të Jezusit me të tjerët.

Një Shikim i Shpejtë MNN



MNN-ja e Indianës Jugperëndimore: Grupi Teen C.A.R.E.

Në vitin 1976, një shkëndijë u ndez brenda MNN-së të Distriktit të Indianës Jugperëndimore, SHBA - për të arritur botën përmes të rinjve. Kjo çoi në krijimin e Grupit Teen C.A.R.E. (Kujdesi për të Arritur të Gjithë), duke u dhënë adoleshentëve mundësinë e tyre të parë për t'u përfshirë në misionin global të Perëndisë. Me pak sponsorizues të rritur, grupe prej 15-30 adoleshentësh zbuluan se dalja nga zonat e tyre të rehatisë kishte një efekt thellësisht transformues në zemrat dhe jetët e tyre.



Këto udhëtime misionare që zhvillohen çdo dy vjet, , fillimisht u organizuan nga MNN-ja dhe RNN-ja, por që nga viti 2014 janë promovuar vetëm nga MNN-ja e Indianës Jugperëndimore. MNN-ja e Indianës Jugperëndimore thekson se këto udhëtime janë më shumë sesa thjesht pushime apo kampe verore - ato janë misione me një ndikim të përjetshëm. Adoleshentët aplikojnë, ndajnë dëshmitë e tyre, intervistohen dhe përballen me sfida, duke mësuar rëndësinë e shërbimit vetëmohues dhe qëndrueshmërisë, shpesh pa komoditete moderne si uji i rrjedhshëm ose ajri i kondicionuar. Gjatë vitit para nisjes, ata ndërtojnë punën e ekipit, planifikojnë projektet e VBS-së dhe ungjillizimit, mbledhin fonde dhe përgatiten shpirtërisht me libra devocionesh dhe një shërbesë dërgimi.



Duke udhëtuar në vende si Hondurasi, Belize dhe Alaska, shumë adoleshentë përjetojnë drejtpërdrejt lëvizjen e Zotit dhe kthehen të frymëzuar për të ndjekur shërbesën me kohë të plotë. Në vitin 2026, fokusi do të zhvendoset tek nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, duke inkurajuar nxënësit e shkollave të mesme të marrin pjesë në eventin për të rinjtë SHBA/Kanada. Christy Boes, Presidente e MNN-së të Distriktit të Indianës Jugperëndimore dhe pjesëmarrëse në udhëtimin e adoleshentëve në vitin 1988, reflekton: “Të rinjtë e sotëm janë të apasionuar dhe të etur. Misioni ynë është t’i angazhojmë, fuqizojmë dhe frymëzojmë ata që të mbajnë pishtarin e punës misionare në të ardhmen, duke tejkaluar edhe ëndrrat tona për mbretërinë e Perëndisë.”



[A mund të shërbeni?](#)

A po ju thërret Perëndia të bashkoheni në misionin e Tij, pavarësisht moshës suaj, për hir të të tjerëve? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT